

## ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Një ankesë kundër K.K.GJILAN

(Shëno emrin e Autoritetit Kontraktues)

Për Aktivitetin e Prokurimit Nr. i AP: 651-25-3835-5-2-1

(Shëno numrin e Aktivitetit të Prokurimit)

Sa i përket tenderit për Rrënimi i objekteve

(Shëno titullin e kontratës si në Dosjen e Tenderit)

### ANKESË

#### 1. Identifikimi i ankuesit\*

"Company Zuka Commerce" Sh.p.k.

(Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj)

Rr. Metush Krasniqi – Nr. 135

(Adresa)

Gjilan

(Vendi)

(Kodi postar)

044 125-938

Muhadin Zuka

(Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj)

shpkzuka@hotmail.com

(Adresa elektronike)

10.06.2025

(Data e parashtrimit të ankesës)

(Nënshkrimi dhe vula)

\*Ankues do të thotë një palë e interesuar për parashtrim të ankesës.

#### 2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i ankesës mund ta parashtroj ankesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse ankesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.



Shëno të dhënat si në vijim:

(Emri i avokatit)

(Adresa e plotë)

(Numri i Telefonit)

(Numri i faks-it)

(Adresa elektronike)

(Data e parashtrimit të ankesës)

(Nënshkrimi dhe vula)

### 3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

Shëno një përshkrim të shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar " Njoftimi për Kontratë" apo "Njoftimi për konkurs të projektimit" dhe, nëse aplikohet "Njoftimi për dhënie të Kontratës" apo "Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit", afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës:

1. Publikimi i Njoftimit për Kontratë në ueb faqe të E-prokurimit: 20.05.2025
2. Procedurë e hapur
3. Lloji i kontratës - Punë ndërtimi
4. Vlera e parashikuar: 250,000.00 €
5. Kriteri për dhënien e kontratës: Tenderi i përgjegjshëm me **Sipas peshimit**
6. Dosja e Tenderit - Version i Korigjuar 30.05.2025
7. Afati i fundit për dorëzimin e tenderit: 10.06.2025; Ora 14:00
8. Kërkesë për rishqyrtim: 03.06.2025
9. Vendim mbi pezullimin e aktivitetit të prokurimit
10. Kërkesë për mirëkuptim nga A.K. nëpërmjet email-it për zgjatje të afatit për shqyrtimin e kërkesës: 05.06.2025
11. Vendimi mbi kërkesën për rishqyrtim për "Company Zuka Commerce" Sh.p.k.- 09.06.2025
12. Vendimi mbi kërkesën për rishqyrtim për "Murseli Company" Sh.p.k.- 09.06.2025

#### 4. Procesi i Hapjes së tenderëve, nëse aplikohet

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po	<input type="checkbox"/>				Jo	<input checked="" type="checkbox"/>	
----	--------------------------	--	--	--	----	-------------------------------------	--

#### 5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, nëse aplikohet

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit? A keni bërë ndonjë reagim me shkrim dhe/ose kërkuar sqarime shtesë nga AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj, si dhe a u është përgjigjur me shkrim AK në lidhje me këtë? Nëse po, ofroni shkurtimisht detaje mbi këtë fakt:

Po	<input type="checkbox"/>				Jo	<input checked="" type="checkbox"/>	
----	--------------------------	--	--	--	----	-------------------------------------	--

#### 6. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs të Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënie të Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

"OE "Company Zuka Commerce" Sh.p.k. në cilësi të palës së interesuar që ka interes juridik material lidhur me aktivitetin e prokurimit: **Rrënimi i objekteve** vlerëson se Autoriteti Kontraktues, ka vepruar në shkelje të parimeve bazike dhe parimeve kryesore, duke shkelur dispozitat qenësore të LPP-së si në vijim:

- 1) Neni 1 të Ligjit Nr.04/L-042, Qëllimi;
- 2) Neni 6 të Ligjit Nr.04/L-042, Ekonomiciteti dhe Efikasiteti;
- 3) Neni 7 të Ligjit Nr.04/L-042, Barazia në Trajtim/ Jo-Diskriminimi;
- 4) Neni 69 të Ligjit Nr.04/L-042, Aftësia Teknike dhe/ose profesionale

**\*\* Sipas Nenit 118 të LPP, OSHP-ja do të kthej tarifën tuaj nëse ankesa aprovohet si e bazuar. OSHP-ja mund të kërkojë një gjobë shtesë deri në 5,000 Euro në rastet kur OSHP-ja konstaton që të gjitha apo cilado nga pretendimet e parashtruara në ankesë kanë qenë e rrejshme ose mashtruese.**

## 7. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

*Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.*

### **Shkaqet e shkeljeve të - Nenit 1**

Qëllimi i këtij ligji i cili është të siguroj në mënyrën më efikase, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publike si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera të autoriteteve kontraktuese në Kosovë.

Ky ligj ka për qëllim të nxisë krijimin e një kulture institucionale të profesionalizuar të pandikuar nga interesat materiale, të paanshme, etike, në mesin e personave zyrtarë që kryejnë ose janë të përfshirë në një aktivitet të prokurimit, duke kërkuar nga personat e tillë që të sjellen duke ndjekur parimin e shfrytëzimit sa më efikas, me kosto ekonomike, transparent dhe të drejtë të fondeve dhe burimeve publike ndërkaq duke iu përmbajtur rreptësisht procedurave dhe kushteve qenësore të këtij ligji.

Në këtë rast AK duke futur kritere të panevojshme dhe paarsyeshme në FDT të kësaj Dosje, ua pamundëson shumë OE pjesmarrjen në këtë aktivitet të prokurimit. Në momentin që shohin kërkesat në Njoftimin për kontratë ose në FDT të Dosjes së Tenderit shumë nga ta heçin dorë nga ky aktivitet i prokurimit ku ulet interesimi dhe zbehet vullneti për pjesmarrje, gjë që ndikon në uljen e konkurrencës dhe ua mundëson palëve të caktuara të konkurojnë me çmime më të larta.

### **Shkaqet e shkeljeve të - Nenit 6**

Të gjitha autoritetet kontraktuese, janë të obliguara që të sigurojnë që fondet publike dhe burimet publike të përdoren në mënyrën më ekonomike, njëkohësisht duke marrë në konsideratë qëllimin dhe lëndën e prokurimit.

Detyrë dhe qëllim kryesor i çdo AK duhet të jetë rritja e konkurrencës në mënyrë që të lejohet qasje maksimale për fondet publike, të ndahet tregu në mesin e numrit të madh të Operatorëve Ekonomik.

Në këtë rast AK – K.K.Gjilan nuk ka vullnet për të arritur që fondet publike të përdoren në mënyrën më ekonomike, duke futur kërkesa të panevojshme arrinë të kontribuoj në uljen e konkurrencës në mes të OE-ve ndërsa OE të caktuar të përfitojnë.

#### **Shkaqet e shkeljeve te - Neni 7**

Autoriteti kontraktues do ti trajtoj operatorët ekonomik në mënyrë të barabartë dhe jo-diskriminuese

Autoriteti kontraktues nuk do të ekzekutojë asnjë aspekt të aktivitetit të prokurimit në një mënyrë që redukton apo eliminon konkurrencën në mes të operatorëve ekonomik ose që diskriminon në dëm ose në të mirë të një ose më shume operatoreve ekonomik.

AK-K.K.Gjilan nuk po i trajton të gjithë OE në mënyrë të barabartë duke zbatuar parimin e mos-diskriminimit që për rrjedhojë eliminohet konkurenca e lire dhe e drejte.

#### **Shkaqet e shkeljeve te - Neni 69 të Ligjit Nr.04/L-042, Paragrafi 1**

(Pika 1) - Autoriteti kontraktues mund të kërkojë nga operatorët ekonomik të sigurojnë dëshmi për të treguar se ata i posedojnë kualifikimet minimale të kërkuara dhe specifikuar në dosjen e tenderit dhe në njoftimin e kontratës. Gjatë vendosjes së kësaj kërkesë, autoriteti kontraktues mund të kërkojë nga operatorët ekonomik që të sigurojnë, nëse është relevante dhe e nevojshme, njërin ose të gjitha dokumentet e specifikuar në këtë nen.

#### **Tek: Kapaciteti teknik dhe profesional**

**Kërkesa 1** - Kjo kërkesë përbën një diskriminim të pajustificuar ndaj OE-ve që marrin pjesë si bashkim operatorësh ekonomikë, duke vendosur një barrë jo proporcionale mbi liderin e konsorciumit. Kjo bie në kundërshtim me frymën e LPP-së, e cila parashikon që kërkesat mbi mundësitë teknike dhe /ose profesionale të operatorëve ekonomikë mund të plotësohen bashkërisht nga të gjithë anëtarët e konsorciumit, dhe jo domosdoshmërisht vetëm nga lideri.

Në cilësinë e operatorit ekonomik të interesuar për këtë procedurë të prokurimit, paraqesim këtë ankesë lidhur me një kriter diskriminues të përfshirë në dosjen e tenderit, konkretisht në **Kërkesën 1 të kriterëve të kapacitetit profesional dhe teknik**, ku thuhet se "Operatori ekonomik (në rast të ofertimit si konsorcium, lideri duhet të përmbush së paku 60% të kërkesës) duhet të dëshmoj se ka realizuar me sukses projekte në rrenimi i objekteve deponive te egra në vlerë të përgjithshme jo më pak se 325,000.00 Euro gjatë periudhës se shkuar 3 (tre) vjeçare...". Kjo kërkesë bie në kundërshtim me nenin 7 të LPP-së, i cili garanton trajtim të barabartë dhe mosdiskriminim të operatorëve ekonomikë.

Vendosja e këtij kufizimi të liderit në minimum 60% përmbushje të kërkesës për projekte të ngjashme:

Shkel të drejtën për të paraqitur ofertë të barabartë si konsorcium dhe kufizon padrejtësisht konkurrencën në treg duke përjashtuar konsorciumet që së bashku mund ta përmbushin kërkesën. I diskriminon operatorët ekonomikë që dëshirojnë të konkurrojnë në formë të përbashkët, edhe pse në total kanë kapacitet të plotë për realizimin e kontratës, Kufizon padrejtësisht format ligjore të bashkëpunimit. Është në kundërshtim me frymën dhe përmbajtjen e LPP-së për lejimin e bashkimit të kapaciteteve.

Në këtë mënyrë, kërkojmë nga autoriteti kontraktues që:

Të rishikojë dhe ndryshojë kriterin në fjalë, duke eliminuar kërkesën që lideri i konsorciumit duhet të përmbushë 60% të kërkesës.

Të lejojë vlerësimin e përbashkët të kapaciteteve të anëtarëve të konsorciumit,

Të zgjatë afatin për dorëzimin e ofertave, në rast se bëhen ndryshime në dokumentacionin e tenderit, në mënyrë që të garantohet mundësi reale për konkurrencë.

**AK me vendimin *mbi kërkesën për rishqyrtim* nuk ka zbatuar: Parimin e trajtimit të barabartë, mosdiskriminimit dhe proporcionalitetit.**

**LPP lejon shprehimisht që operatorët ekonomikë të bashkohen dhe të plotësojnë së bashku kërkesat për kualifikim (kapacitet teknik dhe profesional dhe atë ekonomik dhe financiar).**

**AK e justifikon kërkesën me qëllimin për të siguruar “stabilitetin dhe përgjegjësinë e liderit”.**

**Në rastin e një konsorciumi, përgjegjësia kontraktuale dhe menaxheriale caktohet përmes marrëveshjes së bashkëpunimit, dhe jo përmes kufizimeve arbitrare të përvojës. Nuk ka asnjë dëshmi që përmbushja 60% vetëm nga lideri do të garantojë më shumë stabilitet sesa përmbushja e përbashkët nga konsorciumi.**

**Ne kërkojmë të anulohet kërkesa për përmbushje të 60% të përvojës vetëm nga lideri i konsorciumit.**

#### **Kërkesa - 2.1. Menagjeri i projektit:**

Certifikata për Menaxhim të Kantierit është e pajustificuar dhe potencialisht diskriminuese.

Në Kosovë nuk ekziston një standard i detyrueshëm ligjor apo rregullativ që kërkon një certifikatë të tillë për të ushtruar funksionin e menaxherit të projektit në sektorin e ndërtimtarisë.

Kërkesa për një certifikatë të tillë shkon përtej asaj që kërkohej me ligj, duke përjashtuar inxhinierë që kanë arsimin, përvojën dhe licencat zyrtare (p.sh. nga Oda e Inxhinierëve) por që nuk posedojnë certifikata të veçanta jo të detyrueshme.

Në këtë rast, certifikata shtesë e kantierit:

Nuk është e kërkuar nga ndonjë akt ligjor apo nënligjor në Kosovë;

Nuk justifikohet se pse është e domosdoshme për kontratën konkrete;

Kufizon pjesëmarrjen e profesionistëve të kualifikuar, duke krijuar avantazh të padrejtë për një grup të caktuar.

Gjithashtu kërkesa që menaxheri të ketë përvojë në rrënimin e objekteve është e tepërt dhe përjashtuese.

Kërkesa që menaxheri të ketë përvojë specifike në menaxhimin e një kontrate nga lëmia e rrënimin të objekteve, përjashton profesionistët që kanë menaxhuar projekte të ngjashme në ndërtimtari, por jo domosdoshmërisht vetëm në rrënim.

Rrënimi është një nën-disiplinë e ndërtimtarisë dhe përvojat në ndërtim, mbikëqyrje, riparime strukturore ose projekte publike të ngjashme janë të krahasueshme dhe relevante për natyrën e kontratës.

Kufizimi i tillë nuk është proporcional me kërkesat teknike të kontratës, pasi menaxhimi i projektit nuk kërkon ekspertizë ekskluzive në rrënim, por aftësi të përgjithshme teknike dhe organizative,

të cilat profesionistët e ndërtimtarisë i zotërojnë.

Autoriteti Kontraktues nuk ka ofruar asnjë provë apo dokument që të dëshmojë se kjo certifikatë është e nevojshme për sigurinë apo cilësinë e projektit konkret.

Kërkesa për një certifikatë të tillë ngre një pengesë të panevojshme për konkurrencën, përjashton kandidatë të kualifikuar dhe krijon avantazh të padrejtë për ata pak profesionistë që kanë një certifikatë e cila nuk është pjesë e sistemit publik të kualifikimeve.

Kjo kërkesë ul konkurrencën duke përjashtuar kandidatë të kualifikuar që përndryshe i përmbushin të gjitha kriteret dhe kanë përvojë të konsiderueshme.

Sipas praktikës së vendimeve të OSHP-së dhe LPP-së përvoja duhet të jetë relevante dhe krahasueshme, jo domosdoshmërisht identike.

Parimi i proporcionalitetit në LPP ndalon vendosjen e kërkesave që nuk janë të domosdoshme për natyrën e kontratës.

Në vendimin e tij, AK përmend si arsyetim një pretendim që nuk është bërë nga ne si OE (se “punimet zgjasin 1–2 orë”), duke devijuar nga thelbi i ankesës, që lidhet me kërkesat e pajustificuara për certifikatë dhe përvojë specifike.

Kjo tregon mungesë të trajtimit të duhur të pretendimeve dhe argumentim jo të drejtë, në kundërshtim me detyrimet e transparencës dhe arsytimit të vendimeve në prokurim publik.

Andaj kërkojmë që: Të anulohet kërkesa për certifikatë për Menaxhim të Kantierit si kriter detyrues për Menaxherin e Projektit si dhe të anulohet kërkesa për përvojë specifike vetëm në projekte të rrënimit të objekteve.

Të urdhërohet rishikimi i dokumenteve të tenderit, në përputhje me parimet e LPP-së për konkurrencë të lirë dhe trajtim të barabartë.

### **Kërkesa - 2.3. Inxhinier i diplomuar i gjeodezisë**

Kërkesa për përvojë specifike në *rrënim ose deponi të egra* është e tepërt për një gjeodet. Punët e gjeodezisë janë të ngjashme në shumë fusha, dhe kufizimi i përvojës vetëm në lëminë e kërkuar është i panevojshëm.

Kjo kufizon shumë ofertues të cilët kanë profesionistë të kualifikuar, por që nuk kanë dokumentim në projekte identike.

Kundërshtojmë vendimin e Autoritetit Kontraktues lidhur me kriterin për përvojë specifike në rrënimin e objekteve ose deponi të egra, e kërkuar për inxhinierin e gjeodezisë në kuadër të dokumenteve të tenderit. Ky kriter është i pajustificuar profesionalisht, joproporcional dhe kufizues për konkurrencën, dhe për këtë arsye kërkojmë ndërhyrjen e OSHP-së.

Detyrat e gjeodetit janë standarde dhe të aplikueshme në shumë fusha të ndërtimtarisë dhe infrastrukturës, përfshirë rrënimin, ndërtimin, planifikimin urban, rrugët, ujësjellësin etj.

Përvoja e kërkuar nuk ndryshon në thelb nga një projekt rrënimi të një projekt ndërtimi ose infrastrukture, sa i përket:

- Verifikimit të kufijve të pronësisë;
- Matjeve të koordinatave në terren;
- Përputhjes me dokumentet e planifikimit urban dhe kadastrën.

Verifikimi i kufijve, koordinatave dhe pozicionimi i elementeve në terren janë detyra standarde të gjeodetit, dhe nuk kërkojnë domosdoshmërisht përvojë në “rrënim”.

Kriteri është joproporcional sepse kufizon pjesëmarrjen e operatorëve që kanë gjeodetë të diplomuar e me përvojë profesionale të dëshmuar, por jo domosdoshmërisht në “rrënim”.

Nuk është dëshmuar se kërkohet ndonjë aftësi unike gjeodezike vetëm për rrënim që nuk mund të aplikohet nga përvojat tjera relevante në ndërtimtari.

Andaj kërkohet që të hiqet ose korrigjohet kriteri që kërkon përvojë specifike në rrënim të objekteve/deponi të egra për inxhinierin e gjeodezisë.

#### **Kërkesa - 2.6. Bachelor i diplomuar i komunikacionit**

Pjesëmarrja e një inxhinieri të komunikacionit në një projekt rrënimi është e pazakontë.

Kjo krijon përshtypjen e kërkesës e përshtatur enkas për të favorizuar dikë.

Kërkesa për një profil të tillë në staf, e kombinuar me përvojë të detyrueshme në lëminë e rrënit, kufizon ndjeshëm numrin e operatorëve që mund të aplikojnë.

Në shumë kompani ndërtimore dhe të rrënit, nuk ekziston nevoja për të punësuar inxhinierë të komunikacionit, sepse nuk përbën pjesë thelbësore të veprimtarisë së tyre.

Kjo e bën kriterin diskriminues dhe përjashtues dhe në kundërshtim me parimet e Ligjit për Prokurimin Publik.

**Kundërshtojmë vendimin e Autoritetit Kontraktues për të refuzuar kërkesën tonë për rishqyrtim të kriterit që kërkon një Inxhinier të Komunikacionit me përvojë specifike në rrënim objektiv ose deponi të egra, në kuadër të dokumenteve të tenderit për projektin e rrënit.**

**Ky kriter është: Teknikisht i pajustifikuar; I pazakontë për natyrën e kontratës; Diskriminues dhe kufizues për konkurrencën e lirë.**

**Kërkesa që inxhinieri i komunikacionit të ketë përvojë të dokumentuar në rrënim të objekteve ose deponi të egra është tepër e ngushtë dhe përjashtuese.**

**Ky është një kombinim i dy kushteve të rrepta që eliminojnë një pjesë të madhe të operatorëve ekonomikë, edhe pse ata kanë aftësi dhe staf të kualifikuar në ndërtimtari dhe rrënim.**

**Rrënimi nuk përmban elemente të tilla komplekse të trafikut që të kërkojë ekspertizë ekskluzive dhe përvojë paraprake në të njëjtën lëmi, nga një inxhinier komunikacioni.**

**Referimi i AK-së në “nevojën për devijim të rrugëve dhe shmangie të bllokimeve” është një justifikim i përgjithshëm, i cili nuk përbën bazë të mjaftueshme për një kriter të tillë specifik dhe përjashtues.**

**Andaj kërkohet që të hiqet ose modifikohet kërkesa për përfshirjen e një Inxhinieri të Komunikacionit me përvojë specifike në rrënim objektiv/deponi të egra.**



### **Kërkesa - 2.8. Tre (3) Teknikë të diplomuar**

Profili i teknikëve zakonisht është i orientuar drejt asistencës dhe mbështetjes për inxhinierët, jo drejt drejtimit të proceseve kryesore.

Kërkesa për 5 vite përvojë pune pas diplomimit është më e lartë se ajo që zakonisht kërkohet edhe për inxhinierët baçelor, gjë që tregon mungesë proporcionaliteti.

Në sektorin e ndërtimit dhe rrëtimeve, është praktikë e zakonshme që teknikët të përfshihen në ekupe edhe me 1-3 vite përvojë dhe të kryejnë detyra të natyrës ndihmëse.

Përfshirja e atyre me përvojë të përgjithshme në ndërtimtari është diskriminues, sepse i privon operatorët ekonomikë nga përdorimi i stafit që ka aftësi reale, por nuk ka përvojë të dokumentuar vetëm në projekte të njëjta.

**Ankimojmë vendimin e Autoritetit Kontraktues për refuzimin e kërkesës sonë për rishqyrtim lidhur me kriterin që kërkon përfshirjen e tre teknikëve të diplomuar, secili me së paku 5 vite përvojë pune profesionale pas diplomimit në projekte të rrëimit të objekteve ose deponive të egra. Ky kriter është jo proporcional, teknikisht i pajustificuar, dhe diskriminues, duke kufizuar pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në kundërshtim me nenin 7 të Ligjit për Prokurimin Publik (LPP).**

Kërkesa që përvoja të jetë ekskluzivisht në projekte të rrëimit ose deponive të egra përjashton profesionistë të cilët kanë përvojë relevante në projekte ndërtimore, mirëmbajtjeje apo rehabilitimi, që janë të krahasueshme nga aspekti teknik dhe logjistik.

Kjo krijon një kriter artificial që nuk lidhet drejtpërdrejt me suksesin e realizimit të kontratës, por shërben si barrierë për përjashtimin e operatorëve potencialë.

AK ka deklaruar se “arsimi i teknikëve është i nivelit bazë dhe nuk përbën kosto të madhe për kompaninë”, duke e shmangur plotësisht argumentin kyç të ngritur nga OE, që është kërkesa joproporcionale për 5 vite përvojë specifike.

Kërkojmë që modifikohet kriteri i përfshirjes së tre teknikëve me 5 vite përvojë të ngushtë vetëm në rrëim, dhe të lejohet përvojë më e gjerë në ndërtimtari si e pranueshme.

### **Kërkesa - 2.9 OE pjesëmarrës duhet të paraqes punëtorë të çertifikuar të profileve te ndryshme profesionale - Një (1) armirues**

**Armiruesi** është i panevojshëm në një projekt të rrëimit

Armiruesi është i angazhuar zakonisht në procesin e ndërtimit apo riparimit të strukturave të betonit të armuar, për vendosjen e armaturës sipas projektit.

Në procesin e rrëimit nuk ka asnjë nevojë për ndërtim të ri të betonit të armuar; Nuk ka nevojë për përgatitje të armaturës apo formësimit të saj; Prania e armiruesit nuk sjell vlerë shtesë në këtë fazë. Funksioni i vetëm që përfshin betonin në rrëim është shkatërrimi dhe largimi i tij, që është punë e zakonshme për operatorë të makinerive dhe punëtorë të ndërtimtarisë, jo për armirues.

**Kërkesa - 2.10 - Një punonjës të angazhuar përgjegjës për sigurinë dhe shëndetin në punë i pajisur me certifikatë ose çdo akt juridik relevant (vendim, vërtetim) që dëshmon se është i Certifikuar si Ekspert për Siguri dhe Shëndet në Punë nga MPMS ose MFPT**

Kërkesa për një punonjës të tillë, cënon parimin e konkurrencës së lirë, rrënimi nuk përfshin punë të vazhdueshme në lartësi dhe rreziqet janë standarde dhe të menaxhueshme.

Në Kosovë, numri i ekspertëve të certifikuar për SSP nga MFPT është i kufizuar, dhe një numër akoma më i vogël i tyre janë të punësuar me orar të plotë në kompani ndërtimore.

Vendosja e kësaj kërkesë do të:

- Reduktojnë numrin e OE-ve të mundshëm që mund të aplikojnë;
- Krijojnë avantazh të padrejtë për një grup të vogël kompanish;
- Cenojnë parimin e konkurrencës së lirë dhe të hapur në prokurimin publik (neni 7 i LPP-së).

**Kundërshtojmë vendimin e Autoritetit Kontraktues për të refuzuar kërkesën tonë për rishqyrtim të kriterit që kërkon një Inxhinier të Menaxhimit të Emergjencave me trajnim për Siguri dhe Shëndet në Punë të lëshuar nga kompani të licencuara nga MPMS ose MFPT. Ky kriter është i pajustificuar teknikisht, kufizues, dhe diskriminues, duke reduktuar ndjeshëm konkurrencën e lirë në këtë procedurë. Numri i profesionistëve të certifikuar si Inxhinierë të Menaxhimit të Emergjencave në Kosovë është shumë i kufizuar, dhe numër edhe më i vogël i tyre është i angazhuar në mënyrë të përhershme në kompani ndërtimore.**

**Kërkesa e AK-së vendos një barrë të panevojshme dhe joproporcionale, duke e bërë pothuajse të pamundur për shumë OE të përmbushin këtë kriter, pavarësisht kapaciteteve reale teknike dhe organizative për të realizuar kontratën në mënyrë të sigurt.**

**Numri i profesionistëve të certifikuar si Inxhinierë të Menaxhimit të Emergjencave në Kosovë është shumë i kufizuar, dhe numër edhe më i vogël i tyre është i angazhuar në mënyrë të përhershme në kompani ndërtimore.**

**Kërkesa e AK-së vendos një barrë të panevojshme dhe joproporcionale, duke e bërë pothuajse të pamundur për shumë OE të përmbushin këtë kriter, pavarësisht kapaciteteve reale teknike dhe organizative për të realizuar kontratën në mënyrë të sigurt.**

**Tek: Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe /ose profesionale**

#### **Kapaciteti teknik dhe profesional**

Duke analizuar kërkesat në Dosje të tenderit dhe duke e bërë krahasimin me përshkrimin e pozicioneve në paramasë lehtë mund të vërehet që janë vendosur kërkesa jorelevante duke favorizuar OE të caktuar, me këtë veprim duke ndikuar në uljen e konkurrencës në mes të Operatorëve Ekonomik apo më sakt duke favorizuar një OE të caktuar.

Vlenë të theksohet se përvetësimi i duhur i makinerive ndikon në koston e përgjithshme të ndërtimit (projektit).

Lloji dhe tipi i makinës duhet patjetër t'i përshtatet natyrës së punës, ku bazën e një menaxhimi të mirë në operativë e paraqet sinkronizimi i makinave, kjo arsyetohet sepse pothuajse 15-30% të koston së përgjithshme e përbëjnë makinat, andaj kjo shton rëndësinë e përvetimit të drejtë të tyre.

Reportet e përgatitjes teknike kanë për detyrë që të shqyrtojnë llojin dhe numrin e makinave që do të angazhohen në ndërtim. Për zgjedhjen e mekanizimit të ndërtimit duhet bazuar në : Metodën e realizimit të punës dhe Çmimin e makierive gjatë përdorimit etj

Mekanizimi i duhur për kryerjen e punimeve duhet të zgjedhet në mënyrë të duhur për të arritur objektivat si: Realizimi i efekteve praktike sa më të mëdha dhe Thjeshtësia e shfrytëzimit për zvogëlimin e shpenzimeve.

Në lidhje me dosjen e tenderit për Rrënimin e objekteve, në të cilën janë përcaktuar pozicionet dhe kërkesat për makineri të domosdoshme për zbatimin e projektit, ju njoftojmë se si Operator Ekonomik (OE) kemi vërejtur kërkesa shtesë për makineri të cilat:

- Nuk përkojnë me natyrën reale të punimeve;
- Janë të tepërta në numër;
- Vendosin kufizime të pajustificuara për peshën apo kapacitetin e mjeteve;
- Kanë efekt diskriminues, duke favorizuar operatorë të caktuar.

**Më poshtë po paraqesim ankesën tonë lidhur me secilën prej kërkesave të makinerisë të cilat janë diskriminuese dhe eliminojnë konkurrencën në mes OE-ve:**

#### **1. Eskavator me peshë 2-4 ton (3 copë)**

Kjo kërkesë është e tepërt dhe jo e arsyetuar në raport me përshkrimin teknik të punimeve. Eskavatorët e kësaj peshe përdoren zakonisht për punime urbane të vogla, gërmime të kanalizimeve apo për ndërhyrje në hapësira të kufizuara, ndërkohë që rrënimi i objekteve të përshkruar kërkon mjete më të mëdha. Kërkesa për 3 copë është e ekzagjeruar dhe e panevojshme për realizimin e këtij projekti.

#### **2. Eskavator me peshë 12-18 ton (2 copë)**

Kërkesa specifike që eskavatorët të jenë me peshë ekzaktësisht në intervalin 12-18 tonë është diskriminuese dhe kufizuese, për arsytet e mëposhtme:

Në treg gjenden modele të shumta eskavatorësh me peshë më të ulët ose më të lartë, që janë teknikisht të përshtatshëm dhe efikasë për punime të natyrës së rrënimin. Këto mjete shpesh ofrojnë performancë të barabartë ose më të mirë dhe janë më të disponueshme në treg. Përcaktimi i një kufiri të tillë të ngushtë të peshës pa ndonjë arsyetim teknik të dokumentuar dëmton konkurrencën, duke kufizuar pjesëmarrjen vetëm të operatorët ekonomikë që zotërojnë pajisje brenda këtij diapazoni të ngushtë. Kjo bie ndesh me parimin e trajtimeve të barabarta dhe mosdiskriminimit në prokurim publik.

Nuk është dhënë ndonjë justifikim teknik i qartë se përse kërkohet pikërisht pesha 12-18 tonë, për një aktivitet të përgjithshëm siç është rrënimi i objekteve. Në mungesë të këtij arsyetimi, ky kriter krijon dyshime për favorizim të mundshëm.

#### **4. Kamion kiper me kapacitet mbi 20 m<sup>3</sup> (4 cope)**

Lidhur me kërkuesin tuaj me kamion kiper me kapacitet mbi 20 m<sup>3</sup>, dëshirojmë të parashtrojmë shqetësimin tonë për pajisjet në fjalë, i cili rezulton diskriminues dhe përjashtues, për këto arsye kryesore:

Në treg ka një numër të konsiderueshëm kamionësh kipera me kapacitet më të vogël, të cilët janë teknikisht të përshtatshëm për të kryer të njëjtat funksione me efikasitet të plotë.

Përcaktimi i kapacitetit "mbi 20 m<sup>3</sup>" përjashton padrejtësisht pjesëmarrjen e shumë operatorëve.

Ky kriter teknik shkel parimin e trajtimit të barabartë të operatorëve ekonomikë dhe bie ndesh me nenet përkatëse të Ligjit për Prokurimin Publik, të cilat kërkojnë që specifikimet të jenë neutrale dhe të hapura ndaj konkurrencës.

Kërkesa për kapacitet "mbi 20 m<sup>3</sup>" krijon përshtypjen se është formuluar për të përshtatur specifikat e pajisjeve të një operatori të caktuar, duke ndikuar drejtpërdrejt në rezultatet e garës dhe duke cenuar barazinë e pjesëmarrjes.

Kërkojmë rishikimin e këtij kriteri, dhe sugjerojmë të përdoret një formulim më gjithëpërfshirës dhe i arsyeshëm teknikisht. Ky ndryshim do të: Risë konkurrencën, Garanton pjesëmarrje më të gjerë dhe çmime më konkurruese, Siguron pajisje të përshtatshme për nevojat e institucionit pa kufizime të panevojshme.

Në pritje të një përgjigjeje pozitive dhe me besimin se do të merrni masa për të garantuar barazi në trajtimin e të gjithë pjesëmarrësve.

#### **8. Ngarkues 1-3 ton (2 copë)**

Ngarkues të kësaj peshe janë të përshtatshëm për terrene të ngushta, ndërkohë që në projekt nuk është përcaktuar domosdoshmëria e ndërhyrjes në hapësira të tilla. Për më tepër, kjo kërkesë për dy cope është e ekzagjeruar.

Ngarkuesit me kapacitet 1 deri në 3 ton janë mjete të vogla ndërtimi, zakonisht të përdorura për operacione të lehta, si transportimi i sasisë së vogël të materialeve ndërtimore ose pastrimi i terreneve të vogla.

#### **11. Cisternë uji 8000-12000 litra (2 copë)**

Në përshkrimin bazë është kërkuar autocisternë për spërkatje dhe larje. Kërkesa për cisterna me kapacitet fiks dhe atest vëllimi është kufizuese dhe nuk lejon fleksibilitet teknik. OE mund të ofrojë mjetet e veta me kapacitete të krahasueshme, pa pasur nevojë për përjashtim të pajustificuar.

#### **12. Damper 1-3 ton (1 copë)**

Përdorimi i damperëve të kësaj peshe nuk është praktik për punime rrënimi. Këto mjete janë të përshtatshme për ndërtim të brendshëm apo për lëvizje të vogla në terrene shumë të ngushta. Kërkesa është jashtë kontekstit teknik të projektit.

#### **14. Korpëngritës ≥ 10m (2 copë)**

Nuk është e arsyetuar se ku dhe si do të përdoren këto mjete, pasi në përshkrim nuk figurojnë punime në lartësi që kërkojnë korpëngritës me gjatësi fikse. Kjo kërkesë është specifike, e paargumentuar dhe mund të favorizojë operatorë të caktuar.

#### **16. Autofshise speciale për pastrim pas perfundiumit të punëve me peshë midis 1- 3 ton (2 copë)**

Pastrimi përfundimtar mund të bëhet me mjete të ndryshme në varësi të infrastrukturës së OE. Kërkesa për autofshesë me peshë të caktuar është e kufizuar dhe përjashton oferta të barasvlershme.

**Kundërshtojmë vendimin e Autoritetit Kontraktues (AK) lidhur me refuzimin e kërkesës sonë për rishqyrtim, me të cilën kemi kërkuar rishikimin e kriterëve diskriminues për makineri dhe pajisje në dosjen e tenderit. Vendimi i AK-së është i pabazuar, teknikisht i paarsyetuar dhe në kundërshtim me nenin 7 të LPP-së, sepse:**

- Përcakton specifikime të ngushta dhe të pajustificuara për peshën, kapacitetin ose numrin e makinerive;
- Nuk lejon alternativa teknike të barasvlershme;
- Kufizon konkurrencën dhe krijon mundësi për favorizim.

Në vend që të përcaktohen kapacitete të arsyeshme minimale, AK ka vendosur kriterë me diapazon të ngushtë peshe pa dhënë arsyetim teknik konkret mbi domosdoshmërinë e saktë të këtyre intervaleve.

AK ka dhënë një përgjigje standarde duke thënë se "janë përcaktuar tonazhet minimale dhe maksimale për të garantuar kapacitetin e nevojshëm të punës", por:

- Nuk ka ofruar asnjë analizë që lidh tonazhin me nevojat konkrete të terrenit ose aktivitetit të rrënit;
- Nuk ka trajtuar pretendimin tonë për diskriminim dhe përjashtim të OE-ve që zotërojnë pajisje të barasvlershme teknike;
- Më tej, mbështetja në faktin se mjetet mund të merren me marrëveshje bashkëpunimi nuk e arsyeton kërkesën e padrejtë në thelb. Marrëveshja e bashkëpunimit nuk i eliminon pengesat teknike të krijuara nga përshkrimet kufizuese.

AK në vendimin e kërkesës për rishqyrtim ka thënë se ka mundësuar që makinerite që angazhohen në këtë projekt mund të merren edhe me marrëveshje bashkëpunimi. Kjo nuk është një leje ose lëshim që AK-ja ka kompetencë ta japë. Përdorimi i pajisjeve dhe makinerive të kontraktuara përmes marrëveshjeve bashkëpunimi është e drejtë ligjore e garantuar nga Ligji Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik, dhe çdo operator ekonomik ka të drejtë ta ushtrojë këtë formë përmbushjeje të kërkesave teknike, pa pasur nevojë për miratim paraprak nga AK-ja.

Bazuar në sa më sipër, kërkojmë që të rishikohen dhe modifikohen specifikimet teknike dhe AK të jenë më të kujdesshëm gjatë përgatitjes së dosjeve të tenderit, ku është mirë të konsultohen paraprakisht me inxhinierët e ndërtimit se çka është e nevojshme për Rrënimin e objekteve para se të bëhen kërkesa diskriminuese në dosjen e tenderit.

Autoriteti kontraktues nuk do të ekzekutojë asnjë aspekt të aktivitetit të prokurimit në një mënyrë që redukton apo eliminon konkurrencën në mes të operatorëve ekonomik ose që diskriminon në dëm ose në të mirë të një ose më shumë operatoreve ekonomik.

Në këtë rast AK duke përdorur metoda të ndryshme, duke i ikur përgjegjësisë të cilën e bartin, duke mos iu përmbajtur rreptësisht procedurave dhe kushteve qenësore të këtij ligji, duke ua mundësuar e lehtësuar punën OE të caktuar e në anën tjetër OE-ve të tjerë duke ua vështirësuar punën, bëjnë që të ulët interesimi dhe zbehet vullneti në mënyrë që të heçin dorë nga ky aktivitet i prokurimit dhe jo vetëm.

Nga ana e AK janë shkelur një mori dispozitash ligjore, duke i kufizuar që të jenë të nevojshme dhe proporcionale me objektin e Kontratës.

Siç shihet nga rrethanat faktike, rezulton se janë bërë shkelje të shumta sepse kriteret e përzgjedhjes të vendosura në këtë aktivitet janë përshatur sipas OE-ve të caktuar e jo sipas kërkesave ligjore të prokurimit publik.

Duke u bazuar në faktet e lartshënuara konsiderojmë se AK kanë vepruar në kundërshtim të plotë me dispozitat e LPP-së dhe akteve nënligjore duke bërë diskrimin të qartë ndërmjet OE.

“Company Zuka Commerce” Sh.p.k. në cilësi të palës së interesuar që ka interes juridik material, lidhur me këtë aktivitet të prokurimit kërkojmë nga AK që të hiqen këto kritere diskriminuese, të cilat ulin konkurrencën duke penguar pjesmarrjen e OE të cilët kanë interes të marrin pjesë.

Andaj kërkojmë që të merret:

## **VENDIM**

Të APROVOHET si e bazuar ankesa e OE **“Company Zuka Commerce” Sh.p.k.**

Të KORRIGJOHET dosja e tenderit respektivisht kërkesat mbi mundësitë teknike dhe /ose profesionale

## 8. Dëmet materiale

*Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar i ka shkaktuar ose kërcënohet t'i shkaktojë dëme materiale parashtruesit të ankesës:*

Kompensim i dëmeve materiale për shpenzimet procedurale, kompensim i fitimit të humbur nga kjo punë që do të kërkohet në vazhdim.

## 9. Lista e dokumenteve (dëshmime) të bashkangjitura

*Nëse aplikohet, bashkëngjitni Ankesës dokumentet e renditura më poshtë:*

- *një kopje të publikimit të “Njoftimit për Kontratë” apo “Njoftimit për Konkurs të Projektimit.*
- *një kopje të publikimit për “Njoftimin e Dhënies së Kontratës” apo “Njoftimin për Rezultatet e Konkursit të Projektimit” apo “Njoftimit për Anulim”.*
- *një kopje të letrës së eliminimit të tenderuesit/kandidatit/ letrës se tenderuesit të pasuksesshëm/ letrës për mos para-kualifikim.*
- *një kopje të procesverbalit të hapjes publike të tenderëve, dhe*
- *të gjitha korrespondencat e juaja me autoritetin kontraktues duke përfshirë e-mailat si dhe çdo informatë të shkruar që ka të bëjë me këtë aktivitet prokurimi, si dhe me secilin pretendim të paraqitur në ankesë.*

*\*\*\*Sipas Nenit 111.2 të LPP, Parashtruesi i ankesës, origjinalin e ankesës do t'ia dorëzojë OSHP-së dhe njëkohësisht një kopje do t'ia dërgojë në mënyrën më të shpejtë të mundshme Autoritetit Kontraktues.*